



**VENDIM**

**Nr. 116 Datë 16.11.2011**

**PËR**

**KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES PËR “HEC-ET NE LUMIN ZALLI I OKSHTUNIT” : HEC-ET “BOROVE”, “ZABZUN”, “SEBISHT”, “PRODAN 1”, “PRODAN 2”, “OKSHTUN EKOLOGJIK”, “TERNOVE”, “OKSHTUN”, “LUBALESH 1”, “LUBALESH 2” DHE “GJORICE” SI BURIM I RINOVUESHEM ENERGJIE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2, germa “l”, 9 dhe 39 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar dhe neneve 6, 7 pikat 1 e 2 dhe nenit 9 të Rregullave dhe Procedurave të Çertifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme të miratuara me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 9, datë 21.02.2007, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 16.11.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “DITEKO” sh.p.k për kualifikimin e impiantit prodhues për “HEC-ET “BOROVE”, “ZABZUN”, “SEBISHT”, “PRODAN 1”, “PRODAN 2”, “OKSHTUN EKOLOGJIK”, “TERNOVE”, “OKSHTUN”, “LUBALESH 1”, “LUBALESH 2” DHE “GJORICE” si burim i rinovueshëm energjie,

**Konstatoi se:**

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria “DITEKO” sh.p.k, është konform Rregullave dhe Procedurave të Çertifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme si më poshtë:

**Neni 7, pika 1, germa a,b,c,d**

Përshkrimi i përgjithshëm i centralit.

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

**Neni 7, pika 2, germa a,b,c,d**

Dokumentacioni vijues grafik, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.

Ky dokumentacion është paraqitur në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

## **VENDOSI :**

1. Të kualifikojë impiantin prodhues për “HEC-ET “BOROVE”, “ZABZUN”, “SEBISHT”, “PRODAN 1”, “PRODAN 2”, “OKSHTUN EKOLOGJIK”, “TERNOVE”, “OKSHTUN”, “LUBALESH 1”, “LUBALESH 2” DHE “GJORICE” si burim i rinovueshem energjie.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Sokol RAMADANI**